



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORES,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 3621/2 prot.

Lezhë, më 3. 4 .2025

V E N D I M

Nr. 119 Datë 3 / 4 / 2025

**“PËR VENDOSJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE E EDUKUESE DHE
RREGULLAT PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

Bazuar në ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 79 të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar”, Dekretit Nr.399., datë 05.12.2024 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”, si dhe në Udhëzimin Nr. 6 Datë 23.03.2021 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S A:

1. Përcaktimin e kriterëve për përdorimin e materialeve propagandistike/edukuese dhe përcaktimin e listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë, në zbatim të Udhëzimit Nr.6 Datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.
2. Vendet e caktuara për afishim në qytetin e Lezhës janë: Rruga Bulevardi “Gjergj Fishta”, konkretisht tek hapësira midis shkallëve të Gjykatës dhe të Albtelekomit (aty ku sot janë kabinat telefonike), dhe në qendër të të gjitha njësitë administrative.
3. Vendi për vendosjen e materialeve edukuese, që do të afishohen nga palët e treta, që nuk kanë lidhje me subjektet zgjedhore, është caktuar në çdo holl të zyrave të Gjendjes Civile në Bashkinë Lezhë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Policia Bashkiake, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit; Drejtoria Juridike.
5. Ky vendim hy në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pjerin NDREU

